

HYRJE

Në përputhje me Nenin 2,3,4 dhe 6 të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Nenin 20 dhe 22 të Ligjit Nr. 9723 datë 03/05/2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë Tregtare “ALUFLOR AMERICA” SH.P.K., Znj. Erjola Xheko , atësia Hysen, amësia Sadete, shtetase shqiptare, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Dervish Hima” Pallati “Ambasador 3”, Kati 18, lindur më 22 qershor 1982, e identifikuar nga letërnjoftimi nr. 038106681 ka vendosur sot në ditën e 25 (njetzet e pese) të muajit shtator, të vitit 2023 të hartojë Statutin e një Shoqërie me përgjegjësi juridike të kufizuar nën kushtet e mëposhtme.

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI JURIDIKE TË KUFIZUAR

“ALUFLOR AMERICA” Sh.P.K.

KAPITALI 100 LEKË

SELIA: RRUGA “ASTI GOGOLI”, LAGJIA NR 14, SHKOZET, DURRËS,

SHQIPËRI

KREU I

FORMA, EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 1

FORMA

Themelohet një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos, por jo vetëm, me ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 “Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr. 9723 datë 03/05/2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit”, akteve ligjore që do të jenë në fuqi përgjatë kohës së aktivitetit të Shoqërisë, si dhe me Aktin e Themelimit që i bashkëlidhet këtij Statuti.

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi tregtar i Shoqërisë është “ALUFLOR AMERICA” SH.P.K. Shoqëria mund të përdorë edhe shkurtimin “ALAMER”.


Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga Shoqëria, emërtimi i saj do të ndiqet nga akronimi “Sh.p.k.”, nga tregimi i kapitalit themeltar, të Numrit Unik të Identifikimit të Subjektit dhe nga adresa e selisë.

NENI 3

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i aktivitetit ekonomik dhe financiar të shoqërisë “ALUFLOR AMERICA” Sh.P.K. do të jetë:

- Projektimi, furnizimi, zbatimi i fasadave të ndërtesave të gjitha llojeve, si Fasada xhami, Fasada të ventiluara, skylight, Fasada qelize, struktura metalike, struktura të lehta, dyer, dritare etj etj.
- Importimi dhe eksportimi për nevoja të veta apo të tretëve të materialeve të përmendura në pikën e mësipërme.



- Kryerja e funksionit të ndërmjetësit apo agjentit për përmbushjen e nevojave të të tretëve për prodhimin montimi, dizenjimi, projektimi i çdo lloj materiali që përdoren në proceset e ndërtimit .
- Blerja dhe shitja e kredive, borxheve, cedimi i tyre tek të tretët, apo aktivitete të tjera të ngjashme në fushën financiare.

Pjesëmarrja në shoqëria apo aktivitete me objekt ose qëllime të njëjta apo të përafërta me ata të përshkruar më sipër. Përveç aktiviteteve të listuara më sipër Shoqëria, në kuadër të objektit të saj do të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet industriale apo tregtare të konsideruara të dobishme nga Ortaku, për përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë. Në rast se për ushtrimin e aktiviteteve të sipërpërmendura do të jetë e nevojshme marrja e licencave apo autorizimeve administrative, Shoqëria do të nisë aktivitetet e lidhura me to pasi të jetë pajisur me autorizimet dhe liçencat përkatëse.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia ligjore e Shoqërisë është në adresën vijuese: Durrës, Shqipëri në adresën vijuese: Lagjia Nr 14, Rr. “Asti Gogoli”, Godina 3-kateshe, Zona Kadastrale 8516, Nr. Pasurisë 5/611, Vol. 17, Fq. 168, Shkozet, Durrës.

Selia mund të transferohet përkohësisht në çfarëdo ambienti tjetër të komunës së Tiranës, në një komunë tjetër kufitare, ose kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një vendimi të Ortakut të Vetëm. Në rast të një transferimi të ardhur si pasojë e vendimit të Ortakut të Vetëm, Administratori ka detyrimin e bërjes së ndryshimeve përkatëse në Statutin e Shoqërisë dhe depozitimin brenda afateve ligjorë të dokumenteve të ndryshuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit .

NENI 5

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit ekonomik dhe financiar të Shoqërisë, do të jetë për një periudhë të papërcaktuar në afat, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Kjo periudhë mund të shkurtohet apo zgjatet, gjithnjë në funksion të nevojave të Ortakut Themelues apo të ardhshëm, apo të raporteve tregtare që do të realizohen me Shoqëri të tjera.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KALIMI DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themelor i Shoqërisë është **100 (njëqind) Lekë**, dhe është i përbërë nga një **1 kuotë (një)**, secila me vlerë nominale prej **100 Lekë (njëqind)**.

Rritja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet me Vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 7

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar përbëhet vetëm nga kontributet e Ortakut Themelues të Shoqërisë Znj. Erjola XHEKO.

NENI 8



KALIMI DHE

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Kuota është lirisht e transferueshme nëpërmjet raporteve të trashëgimisë, në rastet e ndarjes së pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, ose ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Në çdo rast në të ardhmen, Ortaku Themeltar pavarësisht numrit të kuotave do të ruajë të drejta specifike përkundrejt ortakëve të tjerë të mundshëm të ardhshëm, në lidhje me të drejtën e parablerjes, të drejtën e veton apo transferimit të kuotave tek të tretë, në rast se Shoqëria do të ketë në një të ardhme më shumë se një ortak.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

NENI 9

VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM

Vendimet e Ortakut të Vetëm merren në përputhje me ligjin, Statutin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, dhe janë të detyrueshme për të gjithë organet e Shoqërisë, edhe pse jo të pranishëm apo jo dakord me to. Ortaku i Vetëm vendos për çështje të tilla si:


- ndryshimi i Statutit,
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë,
- emërimi apo shkarkimi i Administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar, likuidatorëve, përcaktimin e shpërblimit për të sipërpërmendurit,
- zvogëlimi apo rritja e kapitalit themeltar,
- pjesëtimi i kuotave apo anulimi i tyre,
- përfaqësimin e Shoqërisë pranë Gjykatave dhe pranë institucioneve publike në procedimet ndaj Administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar, likuiduesve,
- aprovimin e raporteve të administrimit dhe të kontrollit të Shoqërisë,
- aprovimin e bilanceve vjetore, shpërndarjen e dividendëve, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar te të tretët nëpërmjet shitjes,
- zgjatjen e kohës së aktivitetit ekonomik dhe financiar të Shoqërisë, likuidimin e saj,
- riorganizimin e juridik të Shoqërisë, shndërrimin e saj në Shoqëri Anonime apo Komandite.

NENI 10

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet dhe drejtohet nga Administratori i cili mund të jetë Ortaku ose jo. Administratori zgjidhet nëpërmjet vendimit të Ortakut të Vetëm. Emërimi i Administratorit është e vlefshme për një periudhë 5 vjeçare (pesë) dhe për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së detyrës, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes së parakohshme ose të shkarkimit. Administratori ushtron detyrat e tij, brenda kompetencave dhe pushteteve të parashikuara në këtë Statut. Për gjithçka tjetër që nuk është specifikuar në Statut është kompetent Ortaku i Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në raport me të tretët dhe me Ortakun, Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer veprimet e administrimit të zakonshëm në interes dhe për llogari të Shoqërisë, nëpërmjet veprimeve që vijnë në përputhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, përveç atyre veprimeve që me ligj dhe Statut i perkasin në mënyrë të shprehur Ortakut të Vetëm. Administratori është përgjegjës kundrejt Shoqërisë dhe të tretëve, si për veprime të paligjshme ashtu edhe për veprime të cilat nuk përputhen me sa është parashikuar në Statut përgjatë administrimit të tij.



Administratori duhet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, të zbatojë politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Ortakëve, të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të librave kontabël të Shoqërisë, të përgatisë e nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, ti paraqesë këto të fundit për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve përpara Asamblesë së Ortakëve, të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë, të kryejë të gjitha regjistrimet dhe të dërgojë të gjithë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit.

Administratori kryen të gjithë veprimet që përbëjnë administrim të zakonshëm të shoqërisë, mund të blejë, shesë, këmbëjë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, autovetura dhe makineri, të nënshkruajë për emër e llogari të Shoqërisë kredi pranë institucioneve që veprojnë në këtë fushë, të autorizojë operacione pranë institucioneve bankare në përgjithësi dhe pranë çdo zyre private ose publike. Ai mund të punësojë ose pushojë nga puna punonjës dhe nëpunës, të emërojë Drejtorë ose funksionarë administrativë të Shoqërisë, përfaqësues me prokurë duke përcaktuar edhe kufijtë e mandatit të tyre.

Si Administrator i parë i Shoqërisë, duke filluar nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit emërohet Erjola Xheko, atësia Hysen, amësia Sadete, shtetase shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, me adresë Tiane, lindur më 22 qershor 1982, e identifikuar nga letërnjoftimi nr. 038106681.

KREU IV

VITET FINANCIARE, LLOGARITË VJETORE, DIVIDENDËD

NENI 11

VITET FINANCIARE, LLOGARITË VJETORE

Çdo vit ushtrimor financiar fillon me 1(një) Janar dhe përfundon me 31(tridhjetë e një) Dhjetor. Përfundimisht, ushtrimi i parë financiar përfshin periudhën nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit deri në 31 (tridhjetë e një) Dhjetor. Llogaritë vjetore të pasqyruara në bilancet vjetore, bilancet e konsoliduara, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori ose nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetëm. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore financiare të Shoqërisë bëhet brenda një afati të caktuar prej 3 (tre) muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 12

DIVIDENDËD

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, si dhe pasi të evidentohet fakti se aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajsh, Ortaku i Vetëm përcakton pjesën që u takon atyre në formën e dividendëve mbi fitimin dhe/ose sa do të jetë investimi nëpërmjet rritjes së kapitalit themeltar të Shoqërisë. Fitimi nëse do shpërndahet, do të përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5% e fitimit të çdo viti deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

KREU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË



NENI 13

ZGJATJA E AFATIT

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 (pesë) të Statutit, zgjatja e tij mund të vendoset nga Ortaku i Vetëm.

NENI 14

PRISHJA

Shoqëria prishet në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij Statuti, me përjashtim të rasteve ku bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 16 ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara me ligj. Shoqëria nuk prishet kur ortakët falimentojnë, bëhen të paaftë ose vdesin.

NENI 15

LIKUIDIMI

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit me vendim të Ortakut të Vetëm, ose me prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi Ortaku i Vetëm emërton një ose disa likuidues të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit Ortaku i Vetëm vendos kontributet që i përkasin ortakut, dhe Likuiduesi u shpërndan këtij të fundit vlerën e kapitaleve të Shoqërisë të mbetura.

KREU VI

MOSMARRËVESHJET, LEGJISLACIONI, SHPENZIMET, PËRBËRJA.

NENI 16

MOSMARRËVESHJET, LEGJISLACIONI

Për gjithçka jo të parashikuar në këtë statut do të respektohen normat ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi të cilat rregullojnë aktivitetin e shoqërive tregtare, dhe veçanërisht sa parashikohet në Kodin Civil, ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 “Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Të gjitha kundërshtimet, gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe ortakut, lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë, i nënshtrohen gjyqimit të një Kolegji Arbitrash, të përbërë nga 3 (tre) arbitra të emëruar një nga pala që paraqet ose pretendon një të drejtë ose interes të ligjshëm në çështje, tjetri nga pala kundërshtuese dhe i treti do të zgjidhet me unanimitet nga arbitrat e zgjedhur nga palët. Në rast se nuk ka një emërim unanimitet nga arbitrat, arbitri i tretë emërohet nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku ndodhet selia e shoqërisë.

NENI 17

SHPENZIMET

Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honorarët e paguara për Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë “ALUFLOR AMERICA” Sh.P.K. si dhe aktet që rrjedhin prej tyre i përkasin nënshkruesve të këtij Statuti deri sa Shoqëria të regjistrohet në Regjistrin Tregtar. Nga data e këtij regjistrimi këto shpenzime do të merren tërësisht në ngarkim nga Shoqëria duke i përfshirë në bilancet e saj, dhe do të amortizohen përpara çdo shpërndarje të fitimit, ose e shumta brenda një afati prej 1 (një) viti.

NENI 18

PËRBËRJA

Ky Statut përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) Nene, hartohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë në gjuhën Shqipe me të njëjtën vlerë ligjore e kuptimore

ORTAKU THEMELUES

Erjola XHEKO

Erjola Xheko
